



AAB RIINVEST

BPAL - Institucion i Edukimit Superior Universitar

SYLLABUSI

LËNDA:	MJEDISI BIZNESOR NË KOSOVË	
Niveli i kursit:	Bachelor	
Lloji i kursit:	Zgjedhore	
Viti i studimeve	Viti I	
Semestri:	Semestri II	
Kodi dhe shifra e lëndës:		
Mësimdhënësit e kursit:		e-mail:
	1. Muhamet Sadiku, PhD	m.sadiku@riinvest-uni.net
	3. Albana Gashi Zhinipotoku	

1. Përshkrimi i Lëndës

Lënda mësimore Mjedisi Biznesor ne Kosove jep një pasqyrë të koncepteve themelore të funksionimit të ekonomisë dhe të mjedisit biznesor në nivel nacional. Në veçanti kjo lende trajton mjedisin institucional, mjedisin e politikave ekonomike, për të kaluar më pas në problematikën e zhvillimit makroekonomik të Kosovës, e papunësisë, rritjes ekonomike dhe mënyrën e funksionimit të sistemit bankar ne Kosove. Pasi të krijohet një pasqyrë për mënyrën e funksionimit të ekonomisë se Kosovës kalohet në analizën e mjedisit social, zhvillimit njerëzor, luftimit të varfërisë dhe politikave të tregut të punës. Tema e fundit i kushtohet problemeve specifike të qeverisjes së mire, korrupsionit, ekonomisë joformale dhe ndikimit të tyre në ekonominë e një vendi ne zhvillim siç është Kosova.

2. Qëllimet e Lëndës

Kjo lende lidhur me Mjedisin Biznesor ne Kosove ka për qëllim t'u ofrojë studentëve konceptet kryesore mbi rrethinën biznese ne Kosove, funksionimin e ekonomisë nacionale dhe politikave ekonomike që zbatohen ne Kosove. Kursi ka po ashtu për qëllim rritjen e aftësive të studentëve për të kuptuar dhe analizuar në mënyrë kritike çështjet që lidhen me funksionimin e politikave zhvillimore, institucionet kryesore, dhe barrierat aktuale te biznesit ne Kosove.

3. Rezultatet e Pritura

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike, problemet dhe barrierat biznese në Kosovë,
2. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në zhvillimin e bizneseve ne veçanti dhe te vendit ne përgjithësi,
3. Të vlerësojnë efektet e lidhjeve dhe institucioneve ndërkombëtare dhe në ekonominë e vendit,
4. Te prezantojnë dhe të formulojnë mendimet e tyre nëpërmjet eseve për tema të caktuara.

4. Metodologjia

Çdo javë do mbahet nga 1 ligjëratë (ekuivalente me 2 orë mësimi) dhe 1 ore ushtrime (ekuivalente me 1 orë mësimi). Si gjatë ligjëratave ashtu edhe gjatë ushtrimeve një pjesë e rëndësishme e kohës do t'i kushtohet diskutimeve në klasë. Çdo orë do të jepen detyra ose ese të shkurtra, të cilat pastaj do të diskutohen në orën tjetër. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në vend, gazetat, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim. Esetë e tyre lidhur me këto çështje do të kenë rëndësi për vlerësim. Përveç tekstit bazik në shqip, studentët do të kenë mundësi të shfrytëzojnë fondin e librarisë së UR. Metoda e punës do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësim, me prezantime individuale e grupe, me komente për prezantimet të mesimdhënësve, etj.

5. Literatura

1. Biznesi i vogël dhe i mesëm, botuar nga Insituti Riinvest
 2. Bazat e Ekonomisë dhe roli i qeverisjes, Instituti Riinvest
 3. Profili Socio – Ekonomik i Kosovës, Instituti Riinvest
 4. Raportet e NVM-ve te botuara nga Instituti Riinvest
-

6. Mënyra e vlerësimit:

Testi i parë	20 %
Testi i dytë	20 %
Seminari dhe angazhimi	10 %
Provimi final	50 %

8. Politikat akademike dhe rregulloret e mirësjelljes

Pjesëmarrja ne ligjërata dhe ushtrime është shume e rëndësishme. Studentët inkurajohen që të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave. Profesorët dhe asistentët do të jenë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që u është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët gjithashtu do të jenë të obliguar të marrin pjesë në dy provimet paraprake dhe provimin final që do të organizohen gjatë semestrit. Ata do te mbështeten gjate gjithë kohës për te përvetësuar programin. Studentët inkurajohen te përcjellin diskutimet ne media dhe te pyesin lidhur me ecuritë dhe problemet ekonomike dhe te hapin diskutime lidhur me to.
